



Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë

P r e z e n c a n ë S h q i p ë r i

**Fjala e Hapjes e Ambasadorit Pavel Vacek,
Kryetar i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri
Tryezë e Rrumbullakët mbi Ndryshimin e Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë
25 tetor 2004**

Mirëmëngjes Shkëlqesia Juaj, z. Kryetar i Kuvendit, të nderuar deputetë, të nderuar kolegë, zonja dhe zotërinj!

Do të ishte mjaft e guximshme nga ana ime, duke qenë se sapo kam ardhur në Shqipëri, të flas për çështje kaq delikate dhe komplekse siç është reforma e Rregullores së Kuvendit po të mos ishte ekspertiza e përfutur, njohuritë dhe vendosmëria e bashkëpunëtorëve të mi të Prezencës së OSBE-së, të cilët kanë ndihmuar në materializmin e këtij rishikimi të Rregullores.

Kuvendi i Shqipërisë ka qenë një institucion që ka përjetuar një zhvillim të shpejtë gjatë viteve të fundit dhe ka ambicien të bëhet një forum i vërtetë i debatit politik, shkëmbimeve politike, hartimit të politikave dhe, më e rëndësishmja, i ligjvënies. Njëpërmjet komisioneve të tij hetimore dhe komisioneve të posaçme për disa çështje me rëndësi, Kuvendi është bërë institucioni kyç në kërkimin e konsensusit politik për reformat kryesore institucionale në vend.

Rishikimi i fundit i Rregullores së Kuvendit është bërë në vitin 1998 dhe, për rrjedhojë, ka ardhur koha që, pas përvojës së dy legjislativave, Rregullorja të përditësohet për të pasqyruar nevojat e një institucioni më të pjekur.

Prezenca e OSBE-së dëshiron të vlerësojë rolin udhëheqës të Kryetarit të Kuvendit si dhe anëtarët e tjerë të Grupit të Punës së Rregullores së Kuvendit që kanë marrë përsipër rishikimin e çdo neni të Rregullores ekzistuese si dhe hartimin e ndryshimeve të detajuara.

Gjatë gjashtë muajve të fundit, është bërë një punë e madhe në takimet e përjavshme të Grupit të Punës dhe, marrë së bashku me punën e mëparshme përgatitore të kryer mbi një vit më parë, duhet thënë se puna ka qenë e plotë.

Prezenca e OSBE-së ka patur privilegjin e një ftese nga Kuvendi për të mbështetur punën e tij në këtë drejtim dhe i ka kushtuar kohë dhe përpjekje të konsiderueshme.

Puna e paraqitur këtu sot, përfaqëson një përpjekje shumëpalëshe me qëllim rritjen e transparencës së Kuvendit, qartësimin e procedurave të tij, dhe forcimin e parimeve demokratike mbi të cilat mbështetet.

Janë studiuar një sërë sistemesh parlamentare evropiane: tradita franceze dhe italiane, përvojat nordike, sistemet spanjolle dhe portugeze, holandeze dhe gjermane, si dhe sisteme parlamentare të vendeve të tjera në tranzicion si ato të Polonisë, Rumanisë dhe Sllovenisë.

Rregullorja nuk përbën thjesht një përmbledhje të rregullave të këtyre vendeve, por se shembujt e tyre janë përdorur po aq si zgjidhje të menduara me kujdes sa edhe si mjete për t'iu përgjigjur sfidave të ndryshme, me të cilat përballet sot Kuvendi i Shqipërisë.

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, përmes projektit të saj mbështetës, ka mundur të organizojë për Kuvendin edhe shërbimet e një konsulenti, ekspert nga Parlamenti Evropian për rregulloret. Ky ekspert ka punuar me Departamentin Ligjor të Kuvendit duke dhënë komente dhe analiza mbi propozimet e parashtruara.

Ndryshimet e propozuara që ju janë shpërndarë për rishikim marrin parasysh shumë prej çështjeve të rëndësishme që Prezenca ka ngritur rreth funksionimit të Kuvendit, dhe që i ka konstatuar gjatë viteve të fundit të marrëdhënies së saj të ngushtë me këtë institucion.

Prezenca ka ngritur shqetësimin në lidhje me nevojën për të qartësuar më saktë rolin e Kryetarit të Kuvendit dhe të Sekretarit të Përgjithshëm, mënyrën e formimit të grupeve parlamentare, nevojën për formimin e një komisioni të vetëm kryesues për rishikimin e një pjese të dhënë legjislativ, nevojën për shpërndarjen në kohë të proces-verbaleve të punimeve të Kuvendit dhe zbardhjen e seancave plenare, nevojën për ruajtjen e rregullit dhe etikës, si dhe nevojën për rritjen e mbikqyrjes së qeverisë.

Dy ndryshime të rëndësishme që Prezenca ka mbrojtur janë si vijon:

1) formimi i një Komisioni të vetëm të përhershëm për Integrimin Evropian, si shenjë e angazhimit shumëpalësh në procesin e integritit dhe si një mjet për garantimin e një përfshirjeje më të madhe parlamentare në çështjet evropiane, siç ka qënë edhe eksperiencia e vendeve të BE-së;

2) krijimi i pavarësisë buxhetore të Kuvendit nga qeveria. Kjo do të sigurojë që Kuvendi të ketë burimet që i duhen dhe autonominë e nevojshme për të vendosur në lidhje me përdorimin e tyre. Ne e dimë që nuk mund të japim receta meqënëse këto parime nuk mbështeten shumë në një normë konkrete. Megjithatë, ato mbështeten në praktikën më të mirë të parlamenteve në vendet e BE-së dhe gjetkë.

Harmonia me të cilën bashkëpunuan anëtarët e Grupit të Punës për këto ndryshime të propozuara është për t'u lavdëruar. Tryeza e sotme e rrumbullakët është gjithashtu një shenjë e transparencës më të madhe që kërkohet për mënyrën e funksionimit të Kuvendit.

Shpresoj që prezantimi i sotëm i ndryshimeve të parqajitura nga Grupi i Punës - hera e parë që ato prezantohen jashtë grupit - të nxisë një debat konstruktiv. Duke patur parasysh se në tryezën e sotme janë ftuar edhe ish-Kryetarë të Kuvendit, me një përvojë të pasur, presim me kërkshëri të dëgjojmë pikpamjet tuaja mbi funksionimin e Kuvendit dhe vlerësimin tuaj për ndryshimet e propozuara.

Prezenca e OSBE-së do të vazhdojë të punojë me Kuvendin, në të njëjtën frymë partneriteti, për të mbështetur zbatimin e Rregullores së re, sapo ajo të miratohet dhe të hyjë në fuqi në legjislaturën e ardhshme. Prezenca është duke punuar aktualisht për të mbështetur disa reforma për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara nga administrata e Kuvendit dhe rishikimi i Rregullores është një pjesë kyçe e saj.

Së fundi, më lejoni të theksoj se nuk është rastësi apo thjesht simbolikë që ju drejtohem juve këtu sot, së bashku me Kryetarin e Delegacionit të Komisionit Evropian dhe Ambasadorin e Presidencës së Bashkimit Evropian. Prania dhe përfshirja e të dyja institucioneve tona është tregues i bashkëpunimit dhe sinergjisë që kemi pasur dhe që do të vazhdojmë të kemi për të ndihmuar Kuvendin e Shqipërisë.